



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalhe i Predstavake

ZL.Anr.196/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrien e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të nxitjes të urrejtjes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si e bazuar ankesa e organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 3.000.00 (tresmijë) euro, për shkak të nxitjes së urrejtjes të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

**II. Urdhërohet** subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirëson shkeljen e përcaktuar si në pikën I të këtij dispozitivi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë.

## A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 12.10.2017, me të cilën pretendon se me datën 11.10.2017 në lagjen Arbëria në Prishtinë, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka vendosur poster (me ngjites), me përbajtje politike (premtim politike) në trotuare-rrugë publike. Ndërsa tjetra thekson se këto pllakat janë vendosur nga aktivistë të subjektit politik PDK, të cilët më pas kanë përcjellë tek redaksia e BIRN, komunikatën me shkrim dhe fotot. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur nen 33 pika b) e LZP-së dhe nen 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2017 Partia Demokratike e Kosovës (PDK), theksoi se ankesa ZL.Anr 196/2017 është e pa bazuar pasi që nga foto nuk shihet se janë shpërndarë poster reklamues të subjektit politik PDK, por identifikimi dhe pasqyrimi i gjendjes mjeruese në një pjesë të qytetit, dhe se ato shenja janë vetëm shenja informuese për qytetarët në pjesën që kalojnë për çdo ditë. Subjekti politik PDK, pas marries së kërkuesës për përgjigje me

urdhër, nuk ka ndërmarrë masa përmirësuese. Më tutje, subjekti politik PDK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN të hidhet poshtë si e pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se subjekti politik PDK, ka vendosur poster me përbajtje politike, në trotuare, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33.1 pika i) Kodit të Mirësjelljes, e cila përcakton: “*Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar apo gojore, që nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt tjetrit, duke publikuar fotografi, që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtë janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe urdhëroi që të përmisoj shkeljen dhe nëse nuk vepron në pajtim me këtë urdhër pason sanksioni tjetër. Në përgjigjen e parashtruar nuk është ndërmarrë masa përmirësuese, me arsyetimin se asnjë dispozitë e LPZ-së, nuk e ndalon që në çfarëdo mënyre të tregohet realiteti për një çështje të caktuar. Mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli konform nenit 120.1 pika a) urdhëroi subjektin politik që ta përmisoj shkeljen dhe nëse subjekti politik PDK nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të pasoj sanksioni tjetër.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 196/2017 më datën 16.10.2017.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.